



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**PROJEKT - VENDIM**

Nr.02, datë 26.07.2018

**PËR**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR SEKTORIN E GAZIT (MASTER PLANIT TË SEKTORIT TË GAZIT PËR SHQIPËRINË)**

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 881, datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë), pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) *Strategjia Sektoriale shoqëruar me analizën sektoriale dhe territoriale, vizionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit;*
  - b) *Planin e Zhvillimit të Sektorit, i cili përmban propozimet me përcaktime territoriale, planin e veprimeve dhe projektet e investimeve strategjike;*
  - c) *Rregullorja e Planit;*
  - d) *Vlerësimi Strategjik Mjedisor;*
  - e) *Materiali hartografik.*
2. Ngarkohen të gjitha autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për zbatimin e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë).
3. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislati.

në fuqi dhe nga Plani Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë).

4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit që hartohen nga autoritet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë).
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**DAMIAN GJIKNURI**

**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**